

VENDIM

Nr. 52, datë 31.1.2018

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 218, DATË 11.3.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURAVE DHE RREGULLAVE PËR SHFRYTËZIMIN, NË SIPËRFAQE DHE NËNTOKË, TË ZONAVE QË JANË NGJITUR, ME LEJET EKZISTUESE DHE NDRYSHIMIN E KOORDINATAVE PËR LEJET MINERARE TË PËRCAKTUARA NË HAPËSIRË ME TRI KOORDINATA”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 9, pika 1, dhe 57, pika 2/1, të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 218, datë 11.3.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

I. Në kreun I bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas shkronjës “c”, të pikës 1, shtohet shkronja “ç”, me këtë përmbajtje:

“ç) nga AKBN-ja dhe AKSEM-i vlerësohet se shfrytëzimi i rezervave të mineralit mbi dhe nën lejen ekzistuese fqinje paraqet vështirësi teknike dhe rrezikshmëri për t’u realizuar nga ana e subjektit fqinj.”.

2. Pika 6 riformulohet, si më poshtë vijon:

“6. Afati i vlefshmërisë së lejes për shfrytëzimin në sipërfaqe dhe nëntokë të zonave që janë ngjitur me lejen ekzistuese do të jetë periudha e mbetur e lejes ekzistuese.”.

3. Fjalja e parë, e pikës 9, riformulohet, si më poshtë vijon:

“Prodhimi për sipërfaqen shtesë duhet të llogaritet deri në afatin e mbetur të lejes ekzistuese.”.

II. Pika 2, në kreun III, riformulohet, me këtë përmbajtje:

“2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera dhe Qendra Kombëtare e Biznesit për zbatimin e këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama